Vendim nr. 325, datë 12.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 12.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 52 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ALEKSADËR LAHO,** përfaqësuar nga avokati Luan Hasneziri, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2026-352, datë 10.03.2026 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rigjykim në seancë gjyqësore pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 29, 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1, dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), pas regjistrimit të procedimit penal nr. 235 të vitit 2020, të cilin e ka ndarë dhe në procedimin tjetër penal nr. 235/1 të vitit 2020, ka akuzuar kërkuesin për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 244 dhe 25 të Kodit Penal (*KP*), duke e dërguar çështjen për gjykim.

2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), duke e gjykuar çështjen me procedurën e gjykimit të shkurtuar, me vendimin nr. 12, datë 06.02.2025, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar, duke e dënuar me 1 (një) vit e 3 (tre) muaj burgim. Duke qenë se çështja është gjykuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në aplikim të nenit 406, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), i ka ulur kërkuesit 1/3-ën (një të tretën) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 10 (dhjetë) muaj burgim. Në vendimin e saj GJKKO-ja e Shkallës së Parë, pasi ka parashtruar faktet, indiciet dhe provat e rezultuara nga hetimi, ka arritur në përfundimin se rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri (kërkuesi) i ka premtuar dhe më pas i ka dhënë shtetasit I.K., me detyrë "avokat shteti" pranë Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Durrës, përfitime të parregullta, konkretisht në vlerën 900.000 lekë, me qëllim që ai të kryente një veprim që lidhej me detyrën e tij dhe konkretisht që Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës, ku ai ishte i punësuar, të mos merrte pjesë në procesin gjyqësor me palë paditëse P.S. dhe palë të paditur Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, që zhvillohej në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, si dhe të mos ushtronte ankim ndaj vendimit në fjalë, fakte këto që provohet se kanë ndodhur sipas dosjes gjyqësore.

3. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit, për parashkrim të ndjekjes penale, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka vlerësuar atë të pabazuar. Sipas GJKKO-së Shkallës së Parë dhënia e përfitimit ka ndodhur në datat 13.06.2017 dhe 08.07.2017 dhe nga ky moment e deri në datën që personi nën hetim, kërkuesi, është marrë në cilësinë e të pandehurit, datë 10.06.2022, nuk rezulton të jetë plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale, i cili, në referim të nenit 66, shkronja "ç", të KP-së, në raport me masën e dënimit të parashikuar për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i KP, është 5 vjet. Ndaj vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë kanë bërë ankim kërkuesi dhe Prokuroria e Posaçme.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 41 (87-2025-259), datë 23.7.2025, ka vendosur: "Lënien në fuqi të

vendimit nr. 12, datë 06.02.2025 të GJKKO-së së Shkallës së Parë me këtë ndryshim: "Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 244 dhe 50, shkronja "gj", të KP-së, dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim. Në bazë të nenit 406, paragrafi 1, të KPP-së, kërkuesit i ulet 1/3-ta (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim"". Sipas GJKKO-së së Apelit, ankimi i Prokurorisë së Posaçme është i bazuar, sepse me provat e marra e të shqyrtuara në përputhje me rregullat e gjykimit të shkurtuar, organi i akuzës provon plotësisht vërtetimin, si të ekzistencës së faktit penal të korrupsionit aktiv të funksionarit publik në prezencë të rrethanës rënduese të bashkëpunimit, ashtu edhe fajësinë e të pandehurit (kërkuesit) për kryerjen e kësaj vepre penale. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se provat e ofruara nga akuza provojnë, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 244 i KP-së (përpara ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021), në prezencë të rrethanës rënduese, të parashikuar nga neni 50, shkronja "gj", i të njëjtit kod, sipas kuptimit që i jep bashkëpunimit neni 25 i KP-së.

5. Në vlerësimin e GJKKO-së së Apelit, provat e ofruara nga organi i akuzës provojnë se fakti penal i korrupsionit aktiv të funksionarit publik është kryer nga i pandehuri në bashkëpunim me tjetër person/persona, që, siç vërtetohet nga provat e shqyrtuara, i ka kanë dhënë mbështetjen e tij/tyre në takimet që i pandehuri ka pasur me funksionarin publik, si në prezantimin fillestar, ashtu edhe kur i janë dhënë paratë si përfitim i parregullt që ai (funksionari publik) të mos kryente detyrën e tij, atë të mbrojtjes së interesave të shtetit në një proces gjyqësor ku palë janë institucionet e përcaktuara tipikisht në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar. Lidhur me pretendimin e kërkuesit, për parashkrimin e ndjekjes penale, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se ai është i pabazuar, duke arsyetuar se në përllogaritje aritmetikore të ditës, nga e cila nis afati i parashkrimit me ditën kur kërkuesi është marrë i pandehur, nuk kanë kaluar 5 vjet nga kryerja e veprës penale, sepse akti i fundit korruptiv që provohet se ka kryer kërkuesi është në datën 08.07.2017, ndërsa ai është marrë si i pandehur në datën 10.06.2022. Ndaj vendimit të GJKKO-së së Apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2026-352, datë 10.03.2026, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, arsyetimi i gjykatave më të ulëta në lidhje me pretendimet e kërkuesit për parashkrimin e ndjekjes penale dhe të vërtetimit të përgjegjësisë penale ndaj tij është i drejtë, i marrë në interpretim e në zbatim të drejtë të ligjit dhe, për rrjedhojë, i pacenueshëm, çka i bën pretendimet e të gjykuarit në rekurs

të pabazuara. Lidhur me pretendimin e kërkuesit, për parashkrimin e ndjekjes penale, sipas Kolegjit Penal, në rastin objekt shqyrtimi, kjo vepër penale është konsumuar që në momentin e parë, kur funksionarit publik, me detyrën e avokatit të shtetit i është kërkuar moskryerja e veprimeve që lidheshin me detyrën e tij, kundrejt ofrimit të përfitimit të paligjshëm, si dhe është konsumuar edhe në momentin kur i është dhënë pjesa e fundit e parave. Për rrjedhojë, Kolegji Penal e ka vlerësuar këtë pretendim si të pabazuar, duke arsyetuar se ndjekja penale nuk është parashkruar. Po kështu, Kolegji Penal ka arsyetuar edhe për pretendimet e kërkuesit në drejtim të provueshmërisë së akuzës ndaj tij, duke i vlerësuar ato të pabazuara dhe duke evidentuar se nga gjykatat e faktit është argumentuar gjerësisht dhe në mënyrë ezauruese për ngarkimin me përgjegjësi penale ndaj tij për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar. Në këtë kuptim, edhe në vlerësimin e Kolegjit Penal rezulton e provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerja prej kërkuesit e veprës penale për të cilën është akuzuar e deklaruar fajtor, duke vlerësuar gjithashtu se nga gjykatat më të ulëta është argumentuar në mënyrë logjike, ezauruese dhe në përputhje me parashikimet ligjore për vërtetimin e kryerjes së veprës penale nga kërkuesi, si dhe për pretendimet e tij.

7. Po sipas Kolegjit Penal, fajësia e të gjykuarit (kërkuesit) nuk vërtetohet nga një provë e vetme, por nga një tërësi provash e indicesh, të cilat janë në harmoni të plotë me njëra- tjetrën, në vijë të plotë logjike dhe, për rrjedhojë, të afta të provojnë fajësinë e tij, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, në përputhje me parashikimet e KPP-së. Lidhur me rrethanën e bashkëpunimit, Kolegji Penal e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e GJKKO-së së Apelit, duke arsyetuar se ajo gjykatë iu është referuar të dhënave që kanë rezultuar nga bisedat e regjistruara, pa anashkaluar asnjë prej thënieve të personave protagonistë. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, përfundimi i arritur nga GJKKO-ja e Apelit për rrethanën e bashkëpunimit sjell pashmangshmërisht edhe rritjen e masës së dënimit, duke përbërë bashkëpunimi rrethanë rënduese. Lidhur me rrethanat lehtësuese të pretenduara nga kërkuesi, Kolegji Penal ka vlerësuar se ato nuk prevalojnë ndaj arsyetimit të GJKKO-së së Apelit, që ka analizuar rrezikshmërinë e tij. Po kështu, Kolegji Penal ka arsyetuar se, në rastin konkret, edhe pse kërkuesi është dënuar me 2 (dy) vjet burgim, periudhë kjo që është më e ulët se kufiri tavan prej 5 vjetësh, i parashikuar nga neni 59 i KP-së, për pezullimin e ekzekutimit me burgim dhe vendosjen në provë, ky kriter nuk është i mjaftueshëm për të zbatuar këtë dispozitë (nenin 59 të KP-së), pasi për aplikimin e saj kërkohet domosdoshmërisht rrezikshmëri e pakët e autorit, që në rastin e kërkuesit është e tillë, si dhe një nga kriteret e tjera alternative të parashikuara në paragrafin 1 të saj.

8. Në datën 17.06.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata),* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

9. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

10.1. Është cenuar *parimi i mosdënimit pa ligj*, pasi vepra penale për të cilën akuzohej kërkuesi ishte parashkruar, pasi ajo ishte kryer në datën 31.05.2017, ndërsa njoftimi i akuzës i është bërë në datën 10.06.2022. Pra jashtë afatit 5-vjeçar të parashikuar nga neni 66, shkronja "ç", i KP-së. Ndryshe nga sa kanë arsyetuar gjykatat, vepra penale për të cilën akuzohet kërkuesi konsiderohet e kryer në momentin kur subjekti i veprës penale i premton ose i propozon nëpunësit publik çfarëdolloj përfitimi të parregullt. Ajo është një vepër penale që konsiderohet e kryer në momentin e arritjes së konsensusit ose marrëveshjes se paligjshme. Kjo vepër është një vepër e çastit, e cila konsiderohet e kryer në momentin që subjekti ka kryer veprimin e kundërligjshëm. Ky pretendim i kërkuesit provohet edhe nga provat e administruara në gjykim, konkretisht nga deklarimet e shtetasit I.K. dhe nga shkresa nr. 441/2 prot., datë 31.05.2017 e Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Durrës.

10.2. Është cenuar *e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi edhe pse GJKKO-ja e Apelit ka interpretuar gabim nenin 25 të KP-së, duke zbatuar gabim rrethanën rënduese të bashkëpunimit, që ka sjellë si pasojë rëndimin e dënimit të dhënë ndaj kërkuesit, Kolegji Penal, në vlerësimin që i ka bërë rrethanës së bashkëpunimit, ka dalë jashtë kompetencave të tij, pasi ka bërë vlerësim të provave.

10.3. Gjykatat kanë bërë një interpretim të gabuar të neneve 151 dhe 152 të KPP-së lidhur me kuptimin e provës dhe të çmuarjes së tyre, interpretim i cili ka sjellë si pasojë cenimin e të drejtave kushtetuese. Nga një interpretim i saktë dhe i drejtë i këtyre dispozitave kërkuesi duhej të deklarohej i pafajshëm, pasi nuk provohej fajësia e tij tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

10.4. Nga gjykatat janë interpretuar gabim nenet 47, 48 dhe 59 të KP-së, duke iu caktuar një dënim i ashpër në maksimumin e parashikuar nga ligji, pa asnjë argument ligjor.

10.5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet t'u jepte përgjigje pretendimeve të kërkuesit në seancë gjyqësore dhe jo në dhomën e këshillimit, pasi shkaqet e rekursit kishin të bënin me probleme të rëndësishme të zbatimit të ligjit material dhe procedural penal me pasojë shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe konventore, të cilat nuk mund të merrnin përgjigje në dhomën e këshillimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

11. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kriteret paraprake të legjitimimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *parimit të mosdënimit pa ligj*, për shkak se, sipas tij, vepra penale për të cilën ai akuzohej ishte parashkruar, pasi ajo është kryer në datën 31.05.2017, ndërsa

njoftimi i akuzës i është bërë në datën 10.06.2022. Në këtë kuptim, referuar argumenteve të sjella nga kërkuesi për këtë pretendim, Kolegji vëren se, në thelb, ai lidhet me vlerësimin dhe me interpretimin që i kanë bërë gjykatat e posaçme faktit se kur është momenti që konsiderohet e kryer vepra penale për të cilën ai është akuzuar dhe dënuar. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se edhe gjykatat kanë bërë një interpretim të gabuar të neneve 151 dhe 152 të KPP-së lidhur me kuptimin e provës dhe të çmuarjes së tyre, kanë interpretuar gabim nenet 47, 48 dhe 59 të KP-së dhe se GJKKO-ja e Apelit ka interpretuar gabim nenin 25 të KP-së, duke zbatuar gabim rrethanën rënduese të bashkëpunimit. Sipas kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet t'u jepte përgjigje pretendimeve të tij në seancë gjyqësore dhe jo në dhomën e këshillimit, pasi shkaqet e rekursit kishin të bënin me probleme të rëndësishme të zbatimit të ligjit material dhe procedural penal me pasojë shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe konventore, të cilat nuk mund të merrnin përgjigje në dhomën e këshillimit.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se gjatë zbatimit të ligjit në ushtrim të funksionit të tyre, gjykatat shfaqen edhe si interpretueset e para të normës ligjore (*shih vendimin nr. 45, datë 11.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i atyre gjykatave dhe, për më tepër, i Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 2, datë 14.01.2026; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, gjykatat e zakonshme, veçanërisht Gjykata e Lartë, duhet të interpretojnë parashikimet ligjore në përputhje me qëllimin dhe frymën e ligjvënësit, për të garantuar zhvillimin e një procesi të drejtë dhe respektimin e garantimin e të drejtave kushtetuese të individit. Ndërsa ka pohuar se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë, Gjykata ka theksuar se kur interpretimi dhe zbatimi i ligjit në një çështje konkrete cenon parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë edhe ky interpretim i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 2, datë 14.01.2026; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më lart, referuar agrementeve të mësipërme të kërkuesit, Kolegji konstaton se, *së pari*, në thelb ato kanë të bëjnë me çështjen e interpretimit të elementeve objektive dhe subjektive të veprës penale dhe me interpretimin e ligjit të zbatueshëm, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe kërkuesi nuk ka sjellë ndonjë argument konkret kushtetues për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në këtë drejtim. *Së dyti*, referuar vendimeve gjyqësore që kanë disponuar për çështjen e kërkuesit, Kolegji vëren se gjykatat e posaçme, përfshirë Gjykatën e Lartë, në përputhje me kompetencat e tyre dhe në zbatim të dispozitave materiale dhe procedurale gjatë procesit

gjyqësor, pasi kanë analizuar themelin e çështjes së shtruar për zgjidhje përpara tyre i kanë dhënë kërkuesit përgjigje të arsyetuara për çdo kërkim, duke treguar mënyrën sesi janë vlerësuar indiciet dhe provat në ngarkim të tij, ligjin e zbatueshëm dhe konkluzionet e tyre (*shih paragrafët 2-7 të këtij vendimi*).

16. Referuar vendimit të kundërshtuar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, dhe jo vetëm, por edhe vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta, Kolegji vëren se nuk konstatohen gjetje arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, në kuptimin e gabimeve ligjore ose faktike nga ato gjykata, që të venë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për një gjykim të drejtë. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor gjykatat e posaçme, përfshirë Gjykatën e Lartë, kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkuesit, si dhe fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, nuk mjafton për të provuar dhe për të vënë në dyshim mosrespektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Kërkuesi i ka bazuar pretendimet e tij, në thelb, mbi mënyrën sesi gjykatat kanë vlerësuar pretendimet dhe kërkimet e tij në funksion të zgjidhjes së çështjes në themel. Për rrjedhojë, Kolegji evidenton se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

17. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe jo të vendoste mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit.

18. Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë, në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 52, datë 14.11.2014; nr. 25, datë 10.06.2011; nr. 4, datë 25.02.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara në rekurs, i ka dhënë përgjigje kërkuesit se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së, si dhe ka arsyetuar çdo pretendim të tij, pretendime të cilat janë ngritur edhe në ankimin kushtetues individual të paraqitur në Gjykatë. Vetëm fakti që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për një proces të rregullt, për sa kohë që Kolegji Penal ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, Kolegji vëren se edhe

në këtë drejtim kërkuesit nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji evidenton se edhe ky pretendim i tij është haptazi i pabazuar.

20. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesit, për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi, sipas tij, Kolegji Penal, në vlerësimin që i ka bërë rrethanës së bashkëpunimit ka dalë jashtë kompetencave të tij, për shkak se ka bërë vlerësim të provave, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, Kolegji konstaton se Kolegji Penal, në vlerësimin e rrethanës së bashkëpunimit, nuk ka bërë vlerësim të provave, por i është referuar qëndrimit të mbajtur nga GJKKO-ja e Apelit, të cilin e ka vlerësuar si të drejtë (*shih paragrafin 7 të këtij vendimi*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.